



# FURNIZIMI ME NAFTË: MONOPOL DHE HUMBJE E PARASË PUBLIKE

MONITORIMI I PROKURIMIT PUBLIK NË AGJENCINË QENDRORE TË  
PROKURIMIT

PRILL 2016

COPYRIGHT © 2016.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Kosovë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

## PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA .....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	4
LISTA E SHKURTESAVE.....	5
HYRJE.....	6
METODOLOGJIA .....	6
TRANSPARENCA.....	6
ANALIZA E KONTRATËS .....	7
VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI .....	7
PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT .....	9
VLERËSIMI I OFERTAVE .....	10
ANKESAT DHE VENDIMET .....	13
ZBATIMI I KONTRATËS, MONITORIMI I PERFORMANCËS DHE PAGESAVE .....	14
REKOMANDIME.....	14

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është vazhdimësi e monitorimit paraprak të prokurimit publik në Autoritetin Qendror të Prokurimit (AQP) me qëllim të analizimit të procedurave të tenderimit dhe dhënies së kontratës, monitorimin e zbatimit të kontratës, adresimin e gjetjeve të mundshme si dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e politikave dhe praktikave aktuale.

Aplikimi i prokurimit të centralizuar dhe pse mund të dëmtojë konkurrencën, është i pranueshëm nisur nga premisa për kursim dhe menaxhim më të mirë të parasë publike, e që do të përkthehej në mirëqenie më të mirë për qytetarët. Kështu edhe vetë qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë nëse këto praktika po zbatohen nga AQP dhe vazhdojnë të jenë në të mirën e publikut.

Në procesin e vazhdueshëm për përmirësimin e praktikave të prokurimit publik dhe menaxhimit me paranë publike, KDI si subjekt të kësaj analize ka kontratën e dytë për furnizime të centralizuara me derivate (Nr. AQP-15-001-111) të dhënë nga AQP për Operatorin Ekonomik (OE) HIB Petrol, sh.p.k.

Gjatë kësaj analize kemi gjetur se Operatori Ekonomik (OE), po ashtu fitues i kontratës paraprake kornizë për furnizim me naftë ka rritur premiumët për litër në produkt rreth 137% nga vlerat e kontratës paraprake (AQP-AK-14-002-111), për pothuajse të njëjtat sasi të parashikuara.

Këto çmime janë pranuar nga Autoriteti Kontraktues AQP pa analizë të mirëfilltë dhe kërkesë për sqarime nga OE për arsyen e rritjes së çmimit, duke i kushtuar kështu buxhetit të Kosovës një rritje të shpenzimeve për rreth €371,760.70, sipas sasive totale të parashikuara për tri vite.

Për këtë analizë janë përdorur pothuajse të njëjtat praktika dhe metodologji sikurse për raportin paraprak “Paraja Publike apo Konkurrenca?”, të publikuar nga KDI në dhjetor të vitit të kaluar.

Si konkluzion, AQP, me këtë rast, me qëllim të kursimit të parasë publike, dhe brenda dispozitave aktuale ligjore është dashur të anuloi tenderin në fjalë, dhe të ri tenderojë shërbimet për furnizim me derivate për 80 Autoritete kontraktuese.

Përveç këtyre të gjeturave raporti ofron edhe rekomandime tjera për të shmangur lëshimet e ngjashme të cilat dëmtojnë buxhetin publik.

## LISTA E SHKURTESAVE

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
DT	Dosja e Tenderit
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OE	Operator Ekonomik
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
TI	Transparency International
UA	Udhëzues Administrativ
ZP	Zyrtar i Prokurimit
ZK	Zyra e Kryeministrit

## HYRJE

Instituti Demokratik i Kosovës në dhjetor 2015 ka publikuar raportin mbi monitorimin e punës së Agjencisë Qendrore të Prokurimit të Kosovës<sup>1</sup>, me fokus në kontratën e parë të centralizuar për blerjen e produkteve të konsumit të njëjtë, konkretisht për furnizim me karburante. Kjo kontratë ishte nënshkruar ndërmjet AQP dhe HIB Petrol me 15 shtator 2014, dhe përfshinte 37 Autoritete Kontraktuese, të cilat ishin kyçur në mënyrë vullnetare.

Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ (QRK) – Nr. 02/2015 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik<sup>2</sup>, Neni 3 Paragrafi 2 (duke iu referuar Shtojcës 2), identifikohen 77 autoritete kontraktuese të cilave u hiqet autorizimi për prokurimin e karburanteve dhe artikujve tjerë të konsumit të përbashkët. I njëjti udhëzim obligon AQP-në që të bëjë prokurimin e këtyre artikujve, konform Ligjit Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068, Neni 94<sup>3</sup>. Në përmbushje të këtij obligimi, me datën 07 prill 2015, AQP ka publikuar Njoftimin për Kontratë Nr. AQP-15-001-111, për prokurimin e karburanteve për 79 Autoritete Kontraktuese, nga të cilat 29 ishin pjesë e kontratës paraprake AQP-AK-14-002-111 që skadon me datën 14 shtator 2017.

Ky raport është vazhdimësi e monitorimit paraprak me qëllim të analizimit të procedurave të tenderimit dhe dhënies së kontratës, monitorimin e zbatimit të kontratës, adresimin e gjetjeve të mundshme si dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e politikave dhe praktikave aktuale.

## METODOLOGJIA

Metodologjia e hulumtimit në këtë raport tenton të matë zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik, përmes ekzaminimit të kontratës së AQP për furnizim me derivate për 37 Autoritete Kontraktuese, të cilët janë analizuar në faza të ndryshme. Për shkak të natyrës së kontratës së përzgjedhur, analiza trajton pesë (5) faza të prokurimit: vlerësimin e nevojave dhe planifikimin, përgatitjen e specifikave teknike, vlerësimin e ofertave, ankesat dhe vendimet, si dhe zbatimin e kontratës dhe monitorimin e performancës. Përpos tyre, kjo metodologji trajton nivelin e transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit të Operatorëve Ekonomik (OE), si dhe ankesat e deponuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe vendimet e marra nga ky organ.

Analizimi bëhet përmes metodës krahasuese, ndërmjet kontratës së AQP për furnizim me karburante AQP-AK-14-002-111, e cila është ende valide, si dhe duke analizuar çmimet aktuale të derivateve në tregun me pakicë.

## TRANSPARENCA

Në aspektin e transparencës institucionale, AQP ka demonstruar transparencë të plotë, duke i ofruar brenda afatit ligjor dokumentet e kërkuara, si dhe duke ofruar përgjigje në të gjitha pyetjet dhe komunikimet lidhur me këtë analizë.

<sup>1</sup> <http://kdi-kosova.org/publikime/25-paraja-publike-apo-konkurrenca.pdf>

<sup>2</sup> Udhëzim Administrativ (QRK) – Nr.02/2015 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, miratuar në mbledhjen e 13 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin numër Nr.02/13 me datë 12.02.201

<sup>3</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12172>

## ANALIZA E KONTRATËS

### VLERËSIMI I NEVOJAVE DHE PLANIFIKIMI

Përderisa për kontratën paraprake<sup>4</sup> AQP kishte bërë analiza të hollësishme për përcaktimin e sasive dhe mundësitë e kursimeve, për kontratën në fjalë, 73 nga 80 Autoritetet Kontraktuese(AK) ishin të obliguara të kyçeshin në kontratë të centralizuar, dhe gjashtë (6) AK ishin lajmëruar në mënyrë vullnetare për pjesëmarrje në këtë kontratë. Katër (4) AK, nga lista e autoriteteve qendrore të përfshira në UA 02/2015 sapo kishin hyrë në kontrata për furnizime me derivate, dhe për këtë arsye, nuk ishin kyçur në kontratën në fjalë. Tabela e më poshtme paraqet para masat për kontratën në fjalë sipas specifikave të Dosjes së Tenderit:

Emri i Autoritetit Kontraktues	Diesel për vetura dhe mjete tjera lëvizëse	Diesel për gjenerator	Diesel për nxehe	Benzine vetura	Muaji / Viti i skadimit te kontratës te AK*
Administrata Tatimore e Kosovës	125,000.00	12,000.00	60,000.00	15,000.00	shtator 2017
Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës	44,000.00	6,000.00	-	-	shtator 2016
Agjencia Kosovare e Inteligjencës	40,000.00	20,000.00	80,000.00	1,000.00	shtator 2017
Agjencia Statistikore e Kosovës	12,000.00	-	-	8,000.00	shtator 2017
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	50,000.00	25,000.00	10,000.00	166	shtator 2017
Agjencia Kadastrale e Kosovës	15,000.00	-	-	-	shtator 2017
Agjencia Kosovare e Privatizimit	42,000.00	40,000.00	80,000.00	42,000.00	maj 2016
Agjencia Kundër Korrupsionit	4,000.00	1,500.00	15,000.00	15,000.00	shtator 2017
Agjencia për Administrimin e Aseteve të sekuestruara dhe të Konfiskuara	120,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	shtator 2017
Agjencia Kosovare e Pyjeve	35,000.00	-	-	1,200.00	qershor 2017
Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës	3,000.00	2,378.00	-	3,000.00	shtator 2017
Agjencia Kosovare për Produktet Mjekësore	14,000.00	8,000.00	20,000.00	8,000.00	Maj 2015
Agjencia Kosovare e Pronës	140,000.00	10,000.00	12,000.00	-	Janar 2016
Agjencia Qendrore e Prokurimit	3,000.00	-	-	-	Shtator 2017
Akademia e Kosovës për Sigurinë Publike	50,000.00	-	300,000.00	-	Qershor 2016
Akademia e Arteve dhe Shkencës	4,000.00	-	-	14,000.00	Shtator 2017
Autoriteti i Aviacionit Civil	6,000.00	2,000.00	30,000.00	4,000.00	tetor 2015
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	-	1,000.00	3,000.00	8,000.00	shtator 2017
Autoriteti Rregullativ i Telekomunikimeve	20,000.00	2,000.00	10,000.00	-	janar 2016
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës	4,000.00	13,000.00	-	-	shtator 2015
Doganat e Kosovës	300,000.00	16,000.00	10,000.00	2,000.00	shtator 2017
Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës	3,000.00	100	3,500.00	-	tetor 2017
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	32,000.00	1,900.00	5,000.00	6,000.00	prill 2016
Inspektorati Policor i Kosovës	100,000.00	2,000.00	12,000.00	-	majë 2016
Ombudsperson	12,000.00	2,000.00	4,000.00	1,200.00	shtator 2017
Instituti Albanologjik	5,000.00	5,000.00	2,000.00	1,000.00	shtator 2016
Instituti Gjyqësor i Kosovës	2,000.00	1,000.00	6,000.00	-	shtator 2017
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës	13,000.00	-	-	4,000.00	prill 2016
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	30,000.00	500	6,000.00	5,000.00	mars 2017
Komisioni për Konkurrencë i Kosovës	-	-	-	7,500.00	qershor 2016
Komisioni për Mbështetje Juridike	5,000.00	200	-	3,000.00	maj 2016
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	17,000.00	500	2,500.00	2,000.00	shtator 2017
Komisioni rregullativ i Prokurimit Publik	5,000.00	-	-	3,000.00	shtator 2017
Parlamenti i Kosovës	80,000.00	10,000.00	100,000.00	6,000.00	maj 2016
Ministria e Administratës Publike	60,000.00	40,000.00	100,000.00	2,000.00	shtator 2017
Ministria e Pushtetit Lokal	30,000.00	-	-	-	shtator 2017

<sup>4</sup> AQP-AK-14-002-111

Emri i Autoritetit Kontraktues	Diesel vetura për dhe tjera lëvizëse	Diesel për gjenerator	Diesel për nxehe	Benzine vetura	Muaji / Viti i skadimit të kontratës të AK*
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	120,000.00	6,000.00	175,000.00	40,000.00	korrik 2016
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	90,000.00	500	10,000.00	2,500.00	korrik 2017
Ministria e Diasporës	15,000.00	-	-	-	shtator 2017
Ministria e Drejtësisë	28,000.00	2,500.00	1,000.00	10,000.00	shtator 2017
Ministria e Financave	30,000.00	5,000.00	15,000.00	5,000.00	shtator 2017
Ministria e Forcës së Sigurisë	140,000.00	42,000.00	426,000.00	100,000.00	korrik 2016
Ministria e Infrastrukturës	11,200.00	4,000.00	-	240,000.00	nëntor 2015
Ministria e Integrimi Evropiane	12,000.00	-	-	5,000.00	shtator 2017
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	34,000.00	74,000.00	-	48,000.00	shtator 2015
Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	80,000.00	500	10,000.00	-	shtator 2017
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Shoqërore	152,000.00	12,000.00	420,000.00	132,000.00	nëntor 2015
Ministria e Punëve të Brendshme	300,000.00	100,000.00	75,000.00	30,000.00	maj 2016
Ministria e Punëve të Jashtme	36,000.00	-	-	200	maj 2016
Ministria e Shëndetësisë	60,000.00	-	-	60,000.00	qershor 2016
Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	100,000.00	-	-	20,000.00	mars 2016
Organi Shqyrtues i Prokurimit	14,000.00	-	-	-	mars 2016
Paneli Zgjedhor i Shqyrtimit të Ankesave dhe Parashtrësave	2,800.00	-	-	-	shtator 2017
Policia e Kosovës	2,500,000.00	100,000.00	600,000.00	18,000.00	qershor 2017
Prokuroria e shtetit	93,000.00	12,000.00	26,000.00	13,340.00	shtator 2017
Njësia e Inteligjencës Financiare	90,000.00	4,000.00	10,000.00	3,000.00	mars 2016
Qendra Studentore	5,000.00	-	100,000.00	2,000.00	dhjetor 2015
Qendra Universitare e Klinikës Stomatologjike të Kosovës	3,000.00	-	-	-	maj 2016
Qendra Klinike Universitare e Kosovës	20,000.00	22,000.00	22,000.00	4,000.00	korrik 2016
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	180,000.00	60,000.00	430,000.00	23,000.00	shtator 2017
Sekretariati i Këshillit të Sigurimit të Kosovës	8,000.00	-	-	-	shtator 2017
Shërbimi Korrektues i Kosovës	110,000.00	30,000.00	500,000.00	3,500.00	shtator 2017
Trepça nën administrimin e AKP	-	-	-	-	-
Universiteti i Prishtinës	2,000.00	2,000.00	35,000.00	200	nëntor 2017
Universiteti i Prizrenit	20,000.00	17,000.00	85,000.00	-	korrik 2016
Zyra Administrative Mitrovicë	16,000.00	8,000.00	-	24,000.00	qershor 2016
Zyra e Auditorit Gjeneral	16,000.00	2,000.00	18,000.00	-	qershor 2016
Zyra e Kryeministrit	50,000.00	-	-	35,000.00	shtator 2017
Zyra e Presidentes	60,000.00	-	-	50,000.00	qershor 2016
Zyra e Rregullatorit për Energjisë	6,000.00	7,000.00	-	-	shtator 2017
Zyra e rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave	1,000.00	1,000.00	4,000.00	5,000.00	shtator 2017
Universiteti i Pejës	18,000.00	8,000.00	60,000.00	6,000.00	korrik 2016
Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale	12,000.00	-	-	1,000.00	prill 2016
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës	18,000.00	1,500.00	60,000.00	90,000.00	korrik 2016
Agjencia për menaxhimin e Komplekseve memorial te Kosovës	10,000.00	-	-	-	prill 2016
Këshilli i Kosovës për trashëgimi Kulturore	1,500.00	-	6,000.00	8,500.00	prill 2016
Qendra e shëndetit mendo dhe shtëpia Integruese	6,000.00	2,000.00	20,000.00	6,000.00	qershor 2016
KK Istog	50,000.00	6,000.00	40,000.00	8,000.00	janar 2016
KK Klinë	60,000.00	-	-	10,000.00	nëntor 2016
<b>Gjithsej</b>	<b>6,335,500.00</b>	<b>752,078.00</b>	<b>4,125,000.00</b>	<b>1,181,306.00</b>	

**Tabela 1 – Pasqyrimi i sasive të përafërta për produkt e kërkuar nga secili Autoritet Kontraktues i përfshirë në kontratë**

\* Sqarim: Kolona Muaji / Viti i skadimit të kontratës të AK tregon muajin dhe vitin se kur kontrata ekzistuese e AK skadon, dhe hyn në fuqi furnizimi përmes kontratës AQP-15-001-111.



Këto paramasa ishin llogaritur paraprakisht nga Autoritetet Kontraktuese, si pjesë e planifikimit të prokurimit, të cilat ishin dorëzuar dhe konsoliduar nga AQP konform Ligjit për Prokurim Publik (LPP), dhe UA (QRK) 02/2015 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik.

Gjatë konferencës paraofertuese, Operatorët Ekonomik kishin shfaqur brenga lidhur me furnizimin e derivateve për Ministrinë e Forcave të Sigurisë së Kosovës, për shkak të restriksioneve në specifikat e liferimit të derivateve për këtë Autoritet Kontraktues. Gjithashtu, për shkak të statutit të pa definuar të Trepçës, ishte vendosur që këto autoritete kontraktuese të largoheshin nga lista e përbashkët për furnizime. Gjithashtu, me kërkesë të AK, kësaj liste i është shtuar Universiteti i Mitrovicës. Këto ndryshime kishin zvogëluar numrin e kuantiteteve të kontratës si në vijim<sup>5</sup>:

NR.	NJËSIA MATËSE	PËRSHKRIMI	SASIA E PËRAFËRT PËR 36 MUAJ
1	Litër	Diesel per vetura dhe mjete tjera lëvizëse 10ppm	6,165,500.00
2	Litër	Diesel për gjenerator 10ppm	710,078.00
3	Litër	Diesel për ngrohje 10ppm	3,594,000.00
4	Litër	Benzinë për vetura / Gjenerator 10ppm	1,071,306.00

**Tabela 2 – Pasqyrimi i sasive përfundimtare të përafërta për produkt e kërkuar nga secili Autoritet Kontraktues i përfshirë në kontratë**

## PËRGATITJA E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE DHE DOSJES SË TENDERIT

Specifikat teknike për këtë kontratë janë të titulluara si specifikat teknike të detyrueshme, ku përfshihen sasitë, specifikimet teknike të kualitetit të produktit si dhe kërkesat e përgjithshme. Sikurse edhe në raportin paraprak, Specifikimet teknike të kualitetit të produktit, janë përpiluar konform Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2012 të aprovuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me datën 27.04.2012, i cili përcakton kualitetin e derivateve që janë të lejuara të importohen në Kosovë.

Në vijim, AQP ka përfshirë edhe kërkesat e përgjithshme si në vijim:

***Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, ku Operatorët Ekonomik duhet të përmbushin kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 \ L-42 .***

***Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:***

- Evidenca 1: Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
- Evidenca 2: Certifikata e TVSh- kopje
- Evidenca 3: Certifikata e numrit fiskal- kopje
- Evidenca 4: Licencat për shërbime në sektorin e karburanteve:
  - Licenca e importit - Vërtetimi i Kopjes i noterizuar nga origjinali
  - Licenca për deponim - Vërtetimi i Kopjes i noterizuar nga origjinali

<sup>5</sup> Procesverbali i konferencës paraofertuese-Furnizim me karburante, data 04.05.2015

- Licenca e shitjes me shumicë - Vërtetimi i Kopjes i noterizuar nga origjinali
- Licenca e transportit - Vërtetimi i Kopjes i noterizuar nga origjinali dhe
- Licencën e shitjes më pakicë për pikat e karburantit ku Operatori Ekonomik ofron furnizime me karburante e te cilat i ka ne pronësi apo te marruara me qira - Vërtetimi i Kopjes i noterizuar nga origjinali

*Të gjitha licencat e lëshuara nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet qe te kenë afat të validitetit.*

***Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, ku operatori ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit (2012, 2013 dhe 2014) një xhiro totale të barabartë ose më shumë se 10,000,000.00 Euro.***

***Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:***

- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te natyrës se njëjtë (furnizim me karburante) në 3 (tri) vitet e fundit (2012, 2013 dhe 2014) jo me pak se 8,000,000.00 Euro.
- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në pronësi apo të marruara me qira mjetet transportuese për realizim të kontratës - së paku 3 autobot për diesel dhe 1 autobot për benzinë.
- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj një listë të pikave të shitjes së karburanteve që planifikon për ti shfrytëzuar për realizimin e kontratës.
- Në rast se tenderuesi nuk është prodhues i artikujve të ofruar, tenderuesi duhet te dorëzoj Formularin e Autorizimit nga Prodhuesi;
- Tenderuesi duhet te dorëzoj Certifikatën e cilësisë se mallrave te ofruara nga një Institucion i Pavarur për Certifikim të Cilësisë;

Duke bërë krahasimin me kontratën paraprake të AQP për furnizim me naftë, është vërejtur se në specifikat dhe kushtet e detyrueshme nuk ka pasur ndonjë kriter diskriminues, gjithnjë duke pasur parasysh se kjo është një Kontratë Kornizë e centralizuar për furnizimin e 80 Autoriteteve Kontraktuese.

## **VLERËSIMI I OFERTAVE**

AQP ka shpallur tenderin AQP-15-001-111 me datën 10.04.2015<sup>6</sup>, si dhe ka pasur dy vazhdime të afatit me datat 17.06.2015 dhe 11.08.2015. Në përgjigje të këtij tenderi kishin ofertuar katër kompani; HIB Petrol Sh.P.K., Al-Petrol Sh.P.K., Ex-Fis Sh.P.K., dhe Petrol Company & A-V Gas & Lab Oil. Tabela e më poshtme pasqyron ofertat individuale të secilit OE për premiumin për njësi/produkt, si dhe vlerën totale të ofertës:

<sup>6</sup> <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CitID=ViewNotices&ID=97403>



Në mungesë të përmbushjes së këtyre kriterëve, të dy OE në fjalë ishin vlerësuar si të pa përgjegjshëm.

Është shqetësues fakti që kompanitë me premiume më të lira, e që ishin vlerësuar si të papërgjegjshme gjatë vlerësimit të ofertave për kontratën AQP-AK-14-002-111, edhe këtë herë ishin diskualifikuar për çështje administrative. Kjo tregon një joseriozitet nga ana e OE për të qenë një faktor i rëndësishëm në proces, meqë përveç vlerave më të ulëta të qarkullimeve për tri vitet e fundit, dhe largimit të kërkesës për deponinë për derivatet e konfiskuara nga doganat e Kosovës, kriteret tjera ishin të njëjta me ato të kontratës paraprake.

Me vlerësim të komisionit, kjo kontratë i është dhënë HIB Petrol, si OE i përgjegjshëm me ofertën më të lirë me premiumin prej €0.055 / Litër dhe ofertë totale €634,748.62.

Në tabelën për ndërtimin e çmimeve, AK, njëjtë sikurse edhe në kontratën paraprake, ka specifikuar parametrat për shfrytëzim në ndërtim të çmimeve, të cilat karakterizohen në fikse dhe variabile.

Gjatë analizimit të këtyre parametrave është vërejtur se dy çmime ekonomikisht variabile ende ishin të listuara nga AK si çmime fikse:

1. Premiumi i rafinerisë – është listuar si çmim fiks edhe pse rafineritë janë private, dhe kanë premiume të ndryshme, të cilat ndryshojnë edhe në bazë të rabateve sasiore.
2. Çmimi i transportit për Litër – gjithashtu është listuar si çmim fiks, edhe pse kostoja e transportit ndryshon varësisht nga distanca e furnizimit.

**Gjatë analizës së ofertave është vërejtur se, ndryshe nga kontrata paraprake ku asnjëri nga OE nuk kishte konkurrar me të njëjtën origjinë të furnizimit, ashtu siç KDI e kishte parashikuar si të mundshme gjatë analizimit të kontratës paraprake, këto përkufizime në mënyrë indirekte kishin favorizuar një rafineri/lokacion për furnizim. Tri (3) nga katër (4) ofertat e pranuar kishin listuar OKTA Maqedoni si pikë furnizimi.**

Gjithashtu, gjatë analizimit të çmimit të premiumit të ofruar për njësi, vërejmë se edhe pse kemi të bëjmë me të njëjtin furnitor HIB Petrol Sh.P.K., çmimi i ofruar për njësi është dyfishuar.

Përshkrimi	Sasia e përafërt (Litra)		Premiumi (€)		Dallimi në premium (€)	%
	Kontrata 2014	Kontrata 2015	Kontrata 2014	Kontrata 2015		
Diesel për vetura	6,827,314	6,165,500	0.0260	0.055	0.0290	112%
Diesel për gjenerator	782,594	710,078	0.0199	0.055	0.0351	176%
Diesel për nxemje	3,902,465	3,594,000	0.0199	0.055	0.0351	176%
Benzinë	479,510	1,071,306	0.0159	0.055	0.0391	246%

**Tabela 4 – Krahasimet e premiumeve ndërmjet kontratave AQP-AK-14-002-111 dhe AQP-15-001-111**

*SHËNIM: Arsyeja pse sasi të në kontratën 2015 janë më të vogla se në kontratën 2014 edhe pse kemi të bëjmë me një numër më të madh të Autoriteteve Kontraktuese, është sepse 29 institucione veçse janë në kontratë për të njëjtat furnizime nën kontratën AQP-AK-14-002-111, të cilat vazhdojnë deri në fund të vitit 2017.*

**Rritja e pashpjegueshme prej 137% e çmimit të premiumit është dëmshme për buxhetin publik . Kjo duhet të evitohet përmes përcaktimit të predispozitave ligjore. Nëse bëjmë një krahasim të totalit të premiumit të kontraktuar në dy kontratat aktive të AQP për të njëjtat sasi të përafërta të kontratës së mëhershme (AQP-15-001-111), do të shohim se vlera e përgjithshme është €371,760.70 më shumë, për vlerën e gjithë kontratës, që do të kishte kushtuar me kontratën paraprake.**

Përshkrimi	Sasia e përafërt kontrata 2015 (L)	Premiumi		Totali i Ofertës (€)		Dallimi në vlerë (€)
		Premiumi 2014 (€)	Premiumi 2015 (€)	sipas kontratës AQP-AK-14-002-111	sipas kontratës AQP-15-001-111	
<b>Diesel për vetura</b>	6,165,500	0.0260	0.055	160,303.0000	339,102.500	178,799.50
<b>Diesel për gjenerator</b>	710,078	0.0199	0.055	14,130.5522	39,054.290	24,923.74
<b>Diesel për nxemje</b>	3,594,000	0.0199	0.055	71,520.6000	197,670.000	126,149.40
<b>Benzinë</b>	1,071,306	0.0159	0.055	17,033.7654	58,921.830	41,888.06
<b>TOTALI</b>	<b>11,540,884.00</b>			<b>262,987.92</b>	<b>634,748.62</b>	<b>371,760.70</b>

**Tabela 5 – Pasqyrimi i totalit të ofertës duke krahasuar premiumet e kontratave AQP-AK-14-002-111 dhe AQP-15-001-111**

Në raportin paraprak të KDI-së “Paraja publike apo konkurrenca” të publikuar në dhjetor 2015, është konkluduar se praktikimi i procedurave të prokurimit të centralizuar dëmton konkurrencën direkte, mirëpo kursen parane publike. Duke u nisur nga parimi që praktikata e centralizuara janë vetëm një mjet i kursimit të parasë publike dhe duke iu referuar procedurave të njëjta që ka aplikuar APQ, kursimi do të duhej të ishte reflektuar edhe në kontratën e re të AQP për furnizim me naftë.

KDI është e vetëdijshme që mungesa e ligjeve adekuate lejon që furnitorët të shfrytëzojnë situatat për rritje jo reale me vlerat e marzhës së fitimit. Por për të shmangur humbjen e ose dëmtimin e parasë publike , dhe brenda dispozitave aktuale ligjore, AQP është dashur të anulohet tenderin në fjalë, dhe të ri tenderohet shërbimet për furnizim me derivate për 80 Autoritete kontraktuese.

## **ANKESAT DHE VENDIMET**

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka pasur pesë (5) ankesa të operatorëve ekonomik të deponuara në OShP (165/15 Petrol Company, 221/15 Patroni, 224/15 Graniti Petrol, 394/15 Al-Petrol dhe 401/15 Petrol Company). Të gjitha këto ankesa ishin shqyrtuar nga eksperti shqyrtues i OShP dhe ishin vlerësuar si pa bazë ligjore.

## ZBATIMI I KONTRATËS, MONITORIMI I PERFORMANCËS DHE PAGESAVE

Kontrata në fjalë përmban tri lloje të kushteve: Kushtet e Kontratës, Kushtet e Veçanta të Kontratës si dhe Kushtet e Përgjithshme. Gjithashtu përmban edhe dokumentacionin plotësues si: Tenderi i Furnizuesit duke përfshirë Specifikimet Teknike, Ofertën Financiare, Specifikat Teknike të detyrueshme, Listën e Autoriteteve Kontraktuese, Lokacionet e Pikave të Karburantit, Tabelën e formimit të çmimeve dhe Urdhër blerjen. Kjo kontratë është e publikuar edhe në faqen zyrtare të AQP, komfor kërkesave për transparencë të prokurimeve publike<sup>8</sup>. Ky dokumentacion si tërësi përshkruan në mënyrë detajore obligimet e Autoritetit (autoriteteve) Kontraktues (e) dhe Furnitorit. Sipas Kushteve të Veçanta të Kontratës, Autoriteti Kontraktues identifikohet në dy grupe, AQP që merret me adresimin e çështjeve kontraktuale dhe Autoritetet Kontraktues<sup>9</sup> të identifikuar në listën e autoriteteve kontraktuese, të cilët janë përgjegjës për konsumimin e shërbimit, menaxhimin dhe obligimet financiare. Kontrata në fjalë ka hyrë në fuqi me datën 11 shkurt 2016, dhe ende nuk ka raporte të pagesave, kualitetit apo menaxhimit të kontratës për vlerësim.

## REKOMANDIME

- KDI rekomandon që të rishikohen menjëherë kushtet e përcaktimeve të çmimeve fikse të cilat, edhe pse në përpjekje të minimizimit të kostove të panevojshme, favorizojnë kompani të caktuara;
- Në vend të çmimeve fikse KDI rekomandon të përcaktohen kufijtë minimal dhe maksimal të cilët do të mund të shfrytëzoheshin nga OE gjatë krijimit të çmimeve për njësi.
- KRPP të përpilojë rregullore dhe udhëzime administrative për analizë të tregut, duke përfshirë edhe analizimin e historisë së çmimeve për të vërtetuar se çmimet e pranuar janë të arsyeshme dhe në harmoni me tregun.
- KRPP të rishikojë dispozitat ligjore, dhe të krijojë rregullativa dhe udhëzime për negocimin e kushteve të kontratës me qëllim të sigurimit të termave më të favorshme për institucionet dhe publikun.
- AQP të tregohet më proaktive në identifikimin dhe parandalimin e situatave ku vërehet tendenca nga OE për maksimizimin e fitimit përmes shfrytëzimit të parasë publike.

---

<sup>8</sup> <https://aqp.rks-gov.net/sq/projektet>

<sup>9</sup> Gjithsej 80 Autoritete Kontraktuese, të listuara në Tabelën 1 të këtij raporti.



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

